Kodi i Standardeve
për OJF-të në Shqipëri

KODI I STANDARDEVE PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE NË SHQIPËRI

Mars 2021

© 2021 BY PARTNERS ALBANIA FOR CHANGE AND DEVELOPMENT.
ALL RIGHTS RESERVED

PARATHËNIE

Kodi i Standardeve (KS) të organizatave jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri, është një tërësi parimesh dhe angazhimesh mbi mënyrën se si organizatat zhvillojnë veprimtarinë e tyre; si ato qeverisen, manaxhojnë burimet e tyre, janë transparente dhe llogaridhënëse me të gjithë grupet e interesit, si i ndërtojnë marrëdhëniet me mbështetësit dhe donatorët, si manaxhojnë konfliktin e interesave, etj.

Zbatimi i këtyre parimeve dhe angazhimeve synon vendosjen e një standardi të përbashkët të pranuar, përtej detyrimeve ligjore, mbi veprimtarinë e sektorit, për t`i udhëhequr OJF-të drejt përmirësimit të efektivitetit të punës së tyre dhe rritjen e besimit të grupeve të interesit dhe publikut të gjerë në to.

Kodi është një mekanizëm vetërregullues që ndërmerret me vullnetin e lirë të OJF-ve. **Ai është një mjet për të ndërtuar organizata më të forta dhe më efektive në sektorin jofitimprurës duke krijuar një bazë mbi të cilën praktikat e drejtimit dhe manaxhimit vlerësohen dhe përmirësohen.** Kodi i udhëheq OJF-të në një proces edukimi dhe ndryshimi, drejt standardeve më të larta, duke zhvilluar kështu besimin tek palët e interesuara dhe duke rritur legjitimitetin dhe besueshmërinë e OJF-ve.

Kodi i Standardeve krijon një mundësi për OJF-të për t`i shpjeguar të gjithë grupeve të interesit qofshin këto përfituesit e tyre, mbështetësit, komuniteti i donatorëve, partnerëve nga sektorë të tjerë dhe institucioneve publike mbi parimet dhe mekanizmat që OJF-të ndjekin dhe zbatojnë në punën e tyre të përditshme.

Përmbushja e anagazhimeve të Kodit të Standardeve dhe respektimi i tyre në vijimësi, siguron që OJF-të të jenë transparente dhe llogaridhënëse dhe të zhvillojnë veprimtarinë e tyre me standarde më të larta.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm dhe kanë kontribut kyç në forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e vendit. Ky mekanizëm synon forcimin e marrëdhënies dhe rritjen e besimit të përfituesve e grupeve të interesit ndaj OJF-ve, ç`ka ndikon drejtpërsëdrejti në veprimtarinë e tyre dhe ndikim më të madh të saj në shoqëri.

OJF-të duke u bërë anëtare të Kodit të Standardeve angazhohen të udhëhiqen në punën e tyre nga parimet e përcaktuara në Kod dhe të ruajnë dhe përmirësojnë këto standarde.

Kodi i Standardeve të OJF-ve do të jetë një dokument publik dhe do të shërbejë si referencë dhe udhëzues për sektorin jofitimprurës dhe të gjithë palët e interesuara. Parimet, angazhimet dhe anëtarësia e Kodit, do të promovohen në mënyrë të vazhdueshme, tek të gjithë aktorët e rëndësishëm në vend nëpërmjet platformave dhe aktiviteteve promovuese të dedikuara, si dhe në rajon e më gjerë, si një praktikë vetërregulluese nga vetë sektori për sektorin.

Organizatat anëtare në KS do të jenë lehtësisht të identifikueshëm nën logon e KS dhe do të funksionojnë si një komunitet publik mbështetës dhe mundësues jo vetëm për njëri-tjetrin por për sektorin në tërësi, duke promovuar dhe punuar për avancimin e standardit të tij.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Kodi Standardesh është të rrisë efektivitetin e punës së organizatave jofitimprurëse dhe besimin tek mbështetësit, përfituesit dhe grupe të tjera të interesit, nëpërmjet mirëqeverisjes së sektorit, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

OBJEKTIVAT

- Zbatimi i standardeve të larta të punës nga organet drejtuese dhe ekzekutive të OJF-ve anëtare të Kodit.
- Zbatimi i politikave dhe praktikave vetërregulluese dhe rritja e praktikave transparente dhe llogaridhënëse brenda sektorit jofitimprurës në vend.
- Forcimi i mirëqeverisjes së OJF-ve, manaxhimit efektiv të burimeve financiare dhe njerëzore, rritje e përgjegjshmërisë ndaj përfituesve, mbështetësve dhe aktorëve të tjerë të interesit drejt përmbushjes së misionit të organizatave.
- Koordinimi i përpjekjeve me nisma të tjera rajonale dhe globale në këtë drejtim.

OJF-të anëtare të KS, si vlerë kryesore, kanë respektimin e të drejtave universale të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore.

OJF-të anëtare të KS do të promovojnë dhe advokojnë për drejtësi dhe barazi.

OJF-të anëtare të KS do të nxisin në të gjitha aspektet e punës së tyre, pjesëmarrjen aktive të qytetarëve të interesuar dhe komuniteteve vendore.

OJF-të anëtare të KS do të tregojnë Kujdes për Mjedisin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të tij.

PARIMET E KODIT TË STANDARDEVE

1. OJF-të anëtare të KS, si vlerë kryesore, kanë respektimin e të drejtave universale të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore.

OJF-të anëtare të KS do të respektojnë dhe promovojnë standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. OJF-të anëtare do të jenë gjithëpërfshirëse dhe do të promovojnë të drejta të barabarta për të gjithë, duke adresuar të gjitha format e diskriminimit.

2. OJF-të anëtare të KS do të promovojnë dhe advokojnë për drejtësi dhe barazi.

Anëtarët e Kodit do t`i mbështesin njerëzit në njohjen e të drejtat të tyre dhe vendosjen para përgjegjësisë dhe të qënit llogaridhënës të organeve përgjegjëse për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të tyre, përfshirë dhe vetë OJF-të anëtare të KS. Anëtarët do të advokojnë për adresimin e padrejtësisë, përjashtimit, pabarazisë, varfërisë dhe dhunës për krijimin e një shoqërie të shëndetshme për të gjithë.

3. OJF-të anëtare të KS do të nxisin në të gjitha aspektet e punës së tyre, pjesëmarrjen aktive të qytetarëve të interesuar dhe komuniteteve vendore.

OJF-të anëtare të KS do të sigurojnë që proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet, të reflektojnë dhe t`ju përgjigjen nevojave të individëve dhe grupeve kryesisht të prekur nga puna e tyre, por dhe sugjerimeve nga partnerë, stafi i tyre dhe aktorë të tjerë të interesuar.

4. OJF-të anëtare të KS do të tregojnë kujdes për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

Aktivitetet e OJF-ve anëtare të KS do të zhvillohen në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të nxisin zbatimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Organizata të Hapura dhe Transparente

Organizata të Orientuara drejt Partneritetit

Qeverisje e Mirë

Integritet Organizativ

Financim, Ngritje Fondesh dhe Manaxhim i Burimeve në Mënyrë Etike

Burime Njerëzore të Mirë Manaxhuara

Advokim i Përgjegjshëm

ANGAZHIMET

1.Organizata të Hapura dhe Transparente

OJF-të anëtare të Kodit do të jenë të hapura dhe transparente mbi çfarë ato janë, çfarë bëjnë dhe ofrojnë, përfshirë dhe sukseset dhe dështimet gjatë jetëgjatësisë të tyre.

NËNANGAZHIMET:

A. OJF-të anëtare të Kodit do të ndajnë dhe bëjnë publike informacione lidhur me misionin e tyre, veprimtarinë e organizatave, format dhe mënyrën e marrjes së vendimeve brenda organizatës, burimet si dhe ndikimin e punës së tyre, qoftë ky negativ apo pozitiv, në kohë, në mënyrë të saktë, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.

B. OJF-të anëtare të Kodit do të jenë të hapura ndaj kritikave rreth punës së tyre duke krijuar hapësira për dialog konstruktiv me palët që venë në dyshim veprimtarinë e tyre, me qëllim arritjen e një mirëkuptimi të përbashkët, kur ky është i mundur.

C. OJF-të, anëtare të Kodit, do të jenë të hapura dhe të përgjegjshme në veprimtarinë me institucionet publike, partnerët, donatorët dhe grupet e tjera të interesit.

D. Raportet përshkruese mbi aktivitetin vjetor dhe raportet financiare të OJF-ve anëtare të Kodit do të jenë publike dhe të disponueshme për publikun dhe të gjitha palët e interesuara.

ANGAZHIMET

2. Organizata të Orientuara drejt Partneritetit

OJF-të anëtare të KS do të punojnë në partneritet të drejtë dhe respekt reciprok, në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, konform parimeve të Kodit dhe në zbatim të tij.

NËNANGAZHIMET:

A. OJF-të anëtare të KS do të identifikojnë organizata që punojnë drejt arritjes së qëllimeve të ngjashme dhe do të krijojnë partneritete dhe bashkëpunime, për të përmbushur në nivele të larta, qëllimet e përbashkëta dhe forcimin e mëtejshëm organizativ.

B. OJF-të anëtare të Kodit do të shkëmbejnë informacione, të dhëna, burime dhe njohuri. Vendimet e rëndësishme për sektorin jofitimprurës do të merren në mënyrë të organizuar dhe kur është e mundur në mënyrë kolektive.

Ç. OJF-të anëtare të Kodit do t'u vijnë në ndihmë OJF-ve të tjera, kur u kërkohet dhe e shohin të përshtatshme, në mënyrë që t'i fuqizojnë ato dhe të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen.

D. OJF-të anëtare të Kodit nuk do të mohojnë punën e organizatave të tjera apo të paraqesin deklarata false ose të pasakta për organizatat e tjera. Anëtarët e KS do të njohin kontributin e OJF-ve të tjera dhe mbështetjen e dhënë në arritjet e sektorit.

E. OJF-të anëtare të KS do të respektojnë pavarësinë, misionin dhe veprimtarinë e organizatave të tjera, anëtare ose jo të KS të OJF-ve.

ANGAZHIMET

3. Qeverisje e Mirë

Organizatat anëtare të KS do të sigurojnë qeverisje dhe vendimmarrje sipas strukturave të mirëpërcaktuara dhe në përmbushje të misionit të tyre social. OJF-të do të qeverisen në përputhje dhe respektim të parimeve të Kodit të Standardeve dhe etikës profesionale.

NËNANGAZHIMET:

A. OJF-të anëtare të Kodit do të qeverisen me drejtësi dhe përgjegjësi nga një organ qeverisës i pavarur, aktiv dhe i informuar.

B. OJF-të anëtare të KS do të kenë zhvilluar dokumenta që përcaktojnë qartë misionin, vizionin, vlerat e organizatës, qëllimet e përgjithshme, fushat programatike dhe strukturën qeverisëse dhe vendimmarrëse.

C. OJF-të anëtare të KS, kur e shohin të nevojshme, do të rishikojnë në mënyrë periodike dokumentet bazë të ngritjes dhe funksionimit të strukturave qeverisëse në përshtatje dhe përmbushje të misionit të tyre. Dokumentat bazë do të përfshijnë strukturat dhe procedurat qeverisëse, marrëdhëniet midis punonjësve dhe organeve qeverisëse si dhe proceset e vendimmarrjes.

D. Organi i pavarur qeverisës i secilës organizatë anëtare të KS do të rishikojë dhe aprovojë buxhetin vjetor të organizatës, politikat e rëndësishme, vendimet kryesore financiare, planet dhe programet e organizatës.

E. OJF-të anëtare të KS do të miratojnë politika që parandalojnë dhe administrojnë në mënyrë efektive situatat e konfliktit të interesit.

F. Anëtarët e KS do të kenë zhvilluar dhe zbatojnë politika që ndalojnë diskriminimin dhe promovojnë barazinë gjinore si dhe pjesëmarrjen e grupeve të margjinalizuara në të gjitha nivelet e organizatës.

G. Anëtarët e KS do të kenë zhvilluar dhe zbatojnë politika që parandalojnë dhe administrojnë në mënyrë efektive ngacmimin seksual, bullizmin si dhe sinjalizimin në rast korrupsioni.

ANGAZHIMET

4. Integritet Organizativ

OJF-të anëtare të Kodit do të tregojnë integritet organizativ duke e zhvilluar veprimtarinë e tyre bazuar në një tërësi vlerash dhe praktikash organizative që sigurojnë transparencë, paanshmëri politike dhe partneritet drejt arritjes së qëllimeve statutore.

NËNANGAZHIMET:

A. Veprimtaria e OJF-ve anëtare të KS do të zhvillohet me integritet dhe transparencë. Organizatat do të publikojnë dhe shpërndajnë në mënyrë të plotë, të hapur dhe të saktë, informacione të rëndësishme në lidhje me qëllimet, programet, financat, aktivitetet, rezultatet, efektivitetin dhe qeverisjen e tyre.

B. OJF-të anëtare të KS do të veprojnë sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

C. Anëtarët e KS, nuk do të lejojnë asnjë reklamim apo ndikim të partive ose grupeve politike dhe as të ndikojnë në qëndrimet politike ndaj të tjerëve. Bindjet politike nuk duhet të ndërhyjnë në punën e anëtarëve të KS.

D. OJF-të anëtare të KS do të jenë të pavarur në punën e tyre dhe do të bashkëpunojnë me institucionet shtetërore, donatorët dhe entitetet e tjera bazuar në parimin e barazisë, në përputhje me qëllimet e tyre statutore.

ANGAZHIMET

5. Financim, Ngritje Fondesh dhe Manaxhim i Burimeve në Mënyrë Etike

OJF-të anëtare të KS do t'i administrojnë burimet financiare me përgjegjësi dhe në mënyrë etike për të arritur qëllimet e tyre dhe për t'i shërbyer të mirës publike.

NËNANGAZHIMET:

A. OJF-të anëtare të KS do t`i sigurojnë burimet e tyre në përputhje me parimet e këtij kodi, vlerat dhe misionin e tyre, në mënyrë të pavarura dhe në përmbushje të qëllimeve të organizatës.

B. OJF-të anëtare të KS do t`i përdorin fondet dhe burimet e tyre financiare në mënyrë të përshtatshme dhe të përgjegjshme ndaj donatorëve. OJF-të do të operojnë sipas një buxheti të aprovuar nga organi qeverisës dhe do të kenë politika dhe procedura të miratuara të kontrollit të brendshëm financiar.

C. OJF-të anëtare të Kodit do të operojnë në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe do të sigurojnë kontroll të rreptë financiar, për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit, ryshfetit, keqpërdorimit të fondeve dhe konfliktit të interesit.

D. OJF-të anëtare të KS do të publikojnë raporte vjetore financiare lehtësisht të lexueshme dhe të aksesueshme për të gjithë palët e interesuara.

E. OJF-të anëtare të Kodit do t`i përdorin fondet sipas qëllimeve për të cilat janë zotuar në kërkesën për grant dhe sipas parashtrimeve kontraktuale me donatorin. Kur fondet mblidhen me kontributin e publikut ose kontribuesve të tjerë për një qëllim specifik, organizatat duhet të shprehin qartësisht, qëllimet e tyre në rast mbetje nga fondet e mbledhura.

F. OJF-të anëtare të KS do t`i administrojnë dhe përdorin burimet financiare sipas qëllimit për të cilin janë siguruar në mënyrë që të maksimizojnë ndikimin drejt ndryshimeve pozitive afatgjatë. Donatorët do të kenë akses në informacione mbi fondet e dhëna prej tyre.

ANGAZHIMET

6. Burime Njerëzore të Mirëmanaxhuara

OJF-të anëtare të Kodit të Standardeve do të sigurojnë mirëadministrim të burimeve njerëzore në respektim të kuadrit ligjor, vlerave dhe parimeve të Kodit nëpërmjet politikave të miratuara, duke investuar dhe nxitur zhvillimin e plotë të potencialit profesional të stafit dhe vullnetarëve në përmbushje të qëllimeve të tyre statutore.

NËNANGAZHIMET:

A. Të gjitha OJF-të anëtare të Kodit do të kenë politika dhe procedura të sigurta të rekrutimit të punonjësve, ekspertëve dhe vullnetarëve, të shkruara qartë dhe të mirëpërcaktuara, që mbrojnë dhe sigurojnë diversitetin dhe të drejtën e secilit individ.

B. OJF-të anëtare të Kodit do t'u sigurojnë punonjësve, ekspertëve dhe vullnetarëve përshkrime të qarta të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si dhe pritshmëritë e organizatës ndaj tyre. Politikat e kompensimit dhe përfitimeve do të përshkruhen qartësisht dhe komunikohen periodikisht sipas ndryshimeve të mundshme.

C. OJF-të anëtare të KS do të investojnë në zhvillimin e potencialit të plotë të punonjësve dhe vullnetarëve të tyre, për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

D. OJF-të anëtare të KS do të sigurojnë dhe nxisin përfshirjen e çdo niveli punonjësish në planifikime organizative dhe vendimmarrje, sipas niveleve dhe përgjegjësive të tyre në përputhje me politikat vendimmarrëse.

ANGAZHIMET

7. Advokim i Përgjegjshëm

OJF-të anëtare të Kodit të Standardeve do të angazhohen në adresimin e shkaqeve kryesore të padrejtësive duke u përfshirë në fushata dhe nisma advokuese për një ndryshim rrënjësor.

NËNANGAZHIMET:

A. Organizatat anëtare të Kodit do të sigurohen që advokimi i tyre të bazohet në parime dhe prova konkrete si dhe të pasqyrojë zërat lokalë të grupeve/ komuniteteve të përfshira në nismën e advokimit.

B. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, OJF-të anëtare të Kodit do të ndërmarrin nisma advokimi në frymën e partneritetit dhe përgjegjësisë së përbashkët.

C. Deklaratat e përbashkëta dhe fushatat e advokimit do të konsultohen dhe zbatohen në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e interesuar të Kodit.

ANËTARËSIA NË KOD

Kodi i Standardeve për OJF-të është mjet **vetërregullues**, që do të thotë se përgjegjësia për respektimin e Kodit qëndron kryesisht tek anëtarët e Kodit, të cilët kryejnë një vetëvlerësim bazuar në një tërësi treguesish të verifikueshëm e të përcaktuar në ***Kornizën Vet-Vlerësuese të Kodit të Standardeve të OJF-ve.***

Statusi si anëtar i Kodit të Standardeve të OJF-ve do t`i jepet çdo organizate që i është nënshtruar procesit të vlerësimit dhe rezulton se përmbush kërkesat bazë të treguesve të Kornizës Vet-Vlerësuese të KS.

Anëtarësimi në Kod është vullnetar, aplikimi për të hyrë dhe dalja parakohe nga KS mbetet në vullnetin e organizatës nëse e kërkon këtë gjë.



STRUKTURAT E ZBATIMIT TË KODIT

Strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe promovimin e KS do të jenë:

1. Asambleja e Kodit të Standardeve
2. Komiteti i Kodit të Standardeve
3. Sekretariati i Kodit

Veprimtaria e strukturave të KS dhe procesi i zbatimit të Kodit rregullohet nga një Rregullore e Brendshme.

Rregullorja është hartuar në zbatim të parimeve dhe angazhimeve të Kodit të Standardeve dhe përcakton: strukturat e KS, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre, procedurat e përzgjedhjes së strukturave zbatuese, procesin e vendimmarrjes brenda strukturave zbatuese, procedurat e anëtarësimit në Kod dhe ruajtjes së anëtarësisë, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit gjatë procesit të vlerësimit të aplikimit etj.

ASAMBLEJA E KODIT TË STANDARDEVE

Asambleja e KS për OJF-të në Shqipëri do të përbëhet nga antarësia e Kodit, pra të gjitha organizatat jofitimprurëse të cilat kanë kaluar në procesin e vlerësimit të përmbushjes së standardeve sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Kodin e Standardeve për OJF-të. Anëtarësia e Asamblesë do të jetë publike bashkë me Kodin e Standardeve dhe Kornizën Vet-Vlerësuese të KS. Asambleja e Kodit do të shërbejë gjithashtu si një strukturë analitike, dialoguese dhe mbështetëse për dhe me sektorin jofitimprurës.

KOMITETI I KODIT TË STANDARDEVE

Përmbushja e detyrimeve dhe kërkesave bazë të paracaktuara në Kodin e Standardeve dhe Kornizën Vet-Vlerësuese të KS nga OJF-të, do të sigurohet dhe mbikqyret nga Komiteti i Kodit, i cili do të shërbejë si strukturë vlerësuese për OJF-të që dëshirojnë të anëtarësohen apo të ruajnë anëtarësinë në KS.
Komiteti i Kodit të Standardeve për OJF-të do të përbëhet nga të paktën pesë anëtarë të zgjedhur nga tërësia e organizatave anëtare të Kodit, që përbëjnë dhe Asamblenë e Kodit. Anëtarët e Komitetit do të shërbejnë mbi baza vullnetare.

SEKRETARIATI I KODIT TË STANDARDEVE

Sekretariati i KS do të shërbejë si strukturë informuese, koordinuese dhe lehtësuese në zbatim të KS dhe strukturave të tjera zbatuese të tij. Sekretariati gjithashtu do të jetë përgjegjës për promovimin e KS brenda vendit, në rajon dhe më gjerë si një mekanizëm i rëndësishëm në ngritjen e standardeve të veprimtarisë së sektorit në Shqipëri.
Funksionet e Sekretariatit, do të kryhen nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, 10th Floor, Ap. 71/73,
1010 Tirana, Albania

Telefon: 00355 4 2254 881
Email: info@resourcecentre.al